



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality Kačanik

01 Nr. 16- 9529/2016
Kaçanik, 30.03.2016

RREGULLORE Nr. 03/2016

**PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr.16-27322/12-PËR
ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
KAÇANIKUT**

Mars, 2016

Në bazë të nenit 11, 12.2(c) lidhur me nenet 34.4 dhe 40.2 (a) të Ligjit Nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ të MAPL nr. 2008/08-Për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 36.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe nenit 15.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 30. 03.2016, miratoj këtë:

RREGULLORE Nr. 03/2016

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr.16-27322/12 -PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01Nr. 16 – 27322 /12- Për bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Kaçanikut e datës 31.10.2012.

Neni 2

Ndryshohet në tërësi pika 4.1 e nenit 4 me këtë tekst: - Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të përbëhet prej 3 anëtarëve: një anëtarë nga komuna një anëtar nga Kuvendi (pozita apo opozita), një anëtar nga shoqëria civile. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.

Neni 3

Plotësohet neni 4 i rregullores bazë, i shtohet pika 4.4.4 me këtë tekst: - Rrjeteve sociale

Neni 4

Plotësohet neni 5 pika 5.8, pas fjalisë së fundit, shtohet fjalia - Nuk lejohet të jenë më shumë se një anëtar i familjes në këshillin e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, ndërsa duhet të respektohet përfaqësimi gjinor në strukturën e këshillit.

Neni 5

Ndryshohet pika 5.10 e nenit 5 me këtë tekst: - Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjedhën me mandat 5 vjeçar.

Neni 6

Plotësohet neni 5, shtohet pika 5.12 me këtë tekst: -- Për zëvendës kryetar i këshillit, zgjidhet anëtari, i cili ka marrë vota i dyti në radhë pas kryetarit të këshillit, i cili në raste të caktuara zëvendëson kryetarin e këshillit.

Neni 7

Plotësohet neni 6, shtohet pika 6.5 me këtë tekst: Në qoftë se për çfarëdo arsye nga pikat e cekura më lartë kryetari i këshillit largohet nga detyra, vendin e tij e zëvendëson zëvendëskryetari i këshillit, ndërsa këshilli plotësohet me anëtarin tjetër më të votuar në listën e votimeve të zgjedhjeve .

Neni 8

Hiqet neni 16 i rregullores bazë.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

